

LIGJ
Nr.8211, datë 23.4.1997

**PËR PËRJASHTIMIN E PËRKOHSHËM NGA TAKSAT DOGANORE DHE TVSH-JA TË
DISA IMPORTEVE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Përfshihen përkohësisht nga taksat doganore të importit dhe TVSH-ja makineritë, pajisjet dhe materialet e nevojshme për montimin e tyre, të cilat importohen për t'u investuar në fushën e prodhimit, ndërtimit dhe të shërbimeve në telekomunikacion, banka, si dhe në fushën e furnizimit të popullsisë me ujë dhe energji elektrike.

Neni 2

Këshilli i Ministrave brenda 10 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerrë aktet e nevojshme për zbatimin e tij.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi më 15 maj 1997 dhe ka fuqi deri më 31.12.1997

Shpallur me dekretin nr.1784, datë 25.4.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha